



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE

Kom.Dh.Sh.II.1441/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË, gjyqtari individual Krenar Berisha, në çështjen përbarimore të kreditorit Ndërmarrja Publike Banesore sh.a., me seli në Prishtinë, kundër debitorit M....sh.p.k., me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit M.V. nga Prishtina, për shkak të borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.1095/2021 të datës 31.12.2021, me datën 02.11.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e kreditorit Ndërmarrja Publike Banesore sh.a., me seli në Prishtinë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.1095/2021 të datës 31.12.2021, PRISHET, dhe Lënda kthehet në Dhomën e Shkallës së Parë-Departamenti për çështje ekonomike i Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në rishqyrtim dhe rivendosje

A R S Y E T I M

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.1095/2021, të datës 31.12.2021, e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit M....sh.p.k, me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përbarimit numër P.nr.302/21 të datës 12.08.2021 të lejuar nga Zyra Përbarimore e përbaruesit privat Kushtrim Metaj nga Prishtina.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor kreditori ka parashtruar ankesë dhe atë për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përbarimore dhe konstestimore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozimin që ankesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktvendimi PPP.nr.1095/21 i datës 31.12.2021 të priset, ndërsa Urdhëri përbarimor P.nr.302/21 i datës 12.08.2021 ta lë në fuqi ose lëndën t'ia ktheje Gjykatës Themelore në Prishtinë, në rivendosje. Gjykata e shkallës së parë ka anashkaluar dispozitat ligjore të nenit 329 pika 1 dhe 2 të LPK-së lidhur me nenin n17 të LPP-së për faktin se në rastin konkret në cilësinë e dokumentit përbarues kreditori propozimit për përbarim ia ka bashkangjitur faturën e cila përmban vulën e saktësisë nga origjinali i lëshuar nga kreditori dhe nënshkruar nga personi i autorizuar.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur i autorizuari i debitorit, me propozimin që të refuzohet si e pabazuar ankesa e debitorit, dhe të mbetet në fuqi Aktvendimi Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.1095/2021.

Gjyqtari individual i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori me datë 11.08.2021, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm faturës kthyesë me nr.2021/1915 dhe ekstraktit të verifikuar nga Librat e Kontabilitetit të datës 05.07.2021, për shumën e përgjithshme prej 14,698.24€.

Përmbartuesi Privat Kushtrim Metaj nga Prishtina me urdhrin përmbartimor P.nr.302/2021, të datës 12.08.2021, e ka lejuar përmbartimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm faturës me Nr.2021/1915.

Debitori me kohë ka paraqitur prapsim duke theksuar se e konteston borxhin në emër të qirasë si dhe shpenzimet procedurale sipas kontratës për qiranë për shfrytëzimin e lokalit i cili gjendet në Prishtinë, po ashtu ka theksuar se debitori ka pasur probleme të sigurimit të mjeteve për pagesën e qirasë, për shkak se së pari për të shkak renovimit të lokalit e me tej nga muaji mars i viti 2020 kemi shpalljen e gjendjes emergjente për shkak të Covid 19 dhe mbyllje të lokalit, kurse me vonë puna e bërë në lokal nuk ka mundur që të jemi të rregull në pagimin e qirasë , i njëjti i ka propozuar gjykatës që prapësimi të aprovohet si i bazuar dh të anulohen të gjitha procedurat e përmbartuesit privat për lëndën P.nr.302/21 të datës 12.08.2021.

Përgjigje në prapësim nuk ka parashtuar kreditori.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të prapësimit me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.1095/2021, të datës 31.12.2021, e ka aprovuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbartimit P.nr.302/21 të datës 12.08.2021 të lejuar nga Zyra Përmbartimore e Përmbartuesit Kushtrim Metaj nga Prishtina. Në arsyetim të aktvendimit gjykata e shkallës së parë thekson se urdhri për caktimin e përmbartimit P.nr.302/21 dt.12.08.2021 nuk përbën bazë juridike për caktimin e përmbartimit ngase nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për të qenë dokument përmbartimor. Fatura e lëshuar nga kreditori nuk mbështetet në raportin juridik kontraktual të palëve që do të shërbente si bazë për lëshimin e faturës si dokument i besueshëm, e qe kontrata në këtë rast do të shërbente si titull përmbartimor vetëm në rastin kur do të hartohet tek noteri dhe të vendosej klauzola e plotfuqishmërisë.

Gjykata e Komerciale -Dhoma e Shkallës së Dytë, qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, si dhe me shkelje të nenit 29 paragrafi 1 pika 1.3 të LPP-së.

Aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, sepse arsyet e paraqitura lidhur me faktet vendimtare të çështjes janë paqarta. Gjendja faktike rezulton të mos jetë vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë nga shkresat e lëndës, me çka ka ardhur edhe deri te aplikimi i gabuar i të drejtës materiale, e të cilat shkaqe gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar drejt gjendjen faktike nga shkresat e lëndës, kur dokumentin –faturën nr.2021/1915 datës 01.06.2021, mbi bazën e së cilës është lejuar përmbarimi nga përmbaruesi privat, nuk e ka konsideruar si dokument të besueshëm, duke iu shmangur në tersi shqyrtimit të bazës ligjore nga dispozita e nenit 29 paragrafi 1 pika 1.3 e LPP-së, dhe vërtetimit të fakteve vendimtare ligjore, se a i plotëson kushtet ligjore fatura nr.2021/1915 datës 01.06.2021, për tu konsideruar dokument përmbarues dhe i lejueshëm sipas dispozitës ligjore të lartcekur. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, vendimin e vet nuk e ka mbështetur në asnjë dispozitë ligjore, që parasheh se kontrata e cila nuk është hartuar nga noteri dhe nuk ka klauzolë të plotfuqishmërisë, si e tillë nuk përbën bazë për lejimin e përmbarimit.

Gjykata e shkallës së parë është dashur ta këtë parasysh nenin 37 të LPP i cili thotë se “*Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit të bashkëngjitet dokumenti i tillë në origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*”. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar konform këtij neni ashtu që mbetet të analizohet kjo çështje nga gjykata.

Dhoma e shkallës së parë udhëzohet, që në ri procedurë të bëjë eliminimin e shkeljeve të dispozitave të Ligjit të procedurës përmbarimore, në pajtim me vërejtjet e paraqitura si më lartë, ashtu që të shqyrtoj prapësimin në kuptim të dispozitave të lartcekura, të analizoj dhe vlerësoj edhe një herë provat përkatësisht faturën nr.2021/1915 në bazë të cilit dokument është lejuar përmbarimi, e më pastaj duke vlerësuar edhe shkaqet ligjore nga neni 71 të LPP-së, dhe varësisht nga të gjeturat edhe të vendos.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË
Dhoma e shkallës së dytë
Kom.Dh.Sh.II.1441/2022 me datën 02.11.2022

Gj y q t a r i,

Krenar Berisha